A.K.P.A.
Nr 2958 Prot.
Datë,më 06. 11 .2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "THOMA PAPAPANO", GJIROKASTËR

Nr.141/13 prot.

Gjirokastër, më: 03.11.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit"; Ligjit **nr. 15/2017**, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 554, datë 31.07.2019**, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit **nr.759, datë 30.9.2024**, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit, të udhëzimit **nr.25, datë 01/09/2023** "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional", Shkolla e mesme profesionale **"Thoma Papapano" Gjirokastër**, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1.Instruktor i praktikës profesionale, drejtimi «Hoteleri-Turizëm», me kohë të pjesshme - 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin /cilat po aplikon;
b) Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit:

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) Letërmotivimin për pozicionin;
b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të udhëzimit **nr.759, datë 30.9.2024**;
c) Kartën e identitetit;
d) Diplomën;
e) Librezën e punës;
f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e SHMP «Thoma Papapano», Gjirokastër brenda datës 13.11.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024,"Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit tëvazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTOR
Renata Puleri